



KORRUPSIONI - CILI ËSHTË TREGIMI YT?

DHJETOR 2015

KORRUPSIONI - CILI ËSHTË TREGIMI YT?

**PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE
TË QENDRËS PËR KËSHILLA
LIGJORE ME REKOMANDIME
PËR INSTITUCIONET**

COPYRIGHT © 2015. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të n'a kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45
10000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +381 (0)38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Web: www.kdi-kosova.org

Foto e ballinës: © Kastriot Dragaj

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Ministria e Punëve të Jashtme Gjermane në bashkëpunim me Sekretariatit e Transparency International. Opinione, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jodomosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

PËRMBAJTJA

HYRJE	9
RASTET E RAPORTUARA	8
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK (MZHE)	11
MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE (MAP).....	11
UNIVERSITETI I PRISHTINËS (UP)	11
AGJENSIONI KOSOVAR I PRIVATIZIMIT (AKP)	12
AKTIVITETET TJERA	13
PROMOVIMI I LIGJIT PËR MBROJTJEN E INFORMATORËVE	13
9 DHJETORI, DITA NDËRKOMBËTARE KUNDËR KORRUPSIONIT	13
REKOMANDIMET	15
PËR PROKURIMIN PUBLIK PËRMES KUOTIMIT	15
PËR KONFLIKT INTERESI NË PUNËSIM.....	15
PËR ZBATIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE (RASTIN E FABRIKËS SË TUBAVE)....	15

HYRJE

Pavarësisht disa përparimeve të vogla në reduktimin e korrupsionit, Kosova ende gjendet në fazë të hershme të luftimit të kësaj dukurie. Mungesa e prioritetit të Shtetit për të trajtuar veprat korruptive, mungesa e dënimeve të zyrtarëve të lartë publikë për korrupsion, mungesa e vullnetit politik, ndërhyrjet politike, si dhe mos bashkëpunimi mes institucioneve, kanë krijuar një klimë të mos ndëshkimit të dukurive korruptive në Kosovë.

Prokurimi publik mbetet ende pika kritike ku fondet publike në mënyrë të paligjshme kalojnë në duar të zyrtarëve të lartë të lidhur ngushtë me institucionet udhëheqëse për përfitime private. Gjyqësori i dobët nuk i ka ndihmuar kësaj gjendje.

Korrupsioni vazhdon të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë jetën e qytetarëve. Shkalla e lartë e papunësisë vjen si pasojë e mungesës së investimeve, të cilat në 2015 mbetën larg dyerve të Kosovës, pikërisht nga korrupsioni dhe ngathtësia e gjyqësorit për të garantuar sundimin e ligjit. Liberalizimi i vizave është gjithashtu peng i proceseve të lidhura ngushtë me sundimin e ligjit dhe luftimin e korrupsionit në Kosovë.

Qendra për Këshilla Ligjore dhe Avokim pranë KDI-së motivon përfshirjen aktive të qytetarëve në luftën kundër korrupsionit duke ju ofruar mekanizma të thjeshtë dhe të besueshëm që ata në mënyrë aktive të refuzojnë korrupsionin duke kërkuar mundësi për zgjidhje. Për këtë KDI ka siguruar linjën pa pagesë* në numrin 0800 77 777, ku qytetarët mund të lajmërojnë rastet, si dhe adresën elektronike info@kdi-kosova.org. Pas raportimit, këshilltari ligjor komunikon me qytetarët dhe shqyrton bashkë me ta rastet e raportuara, duke i përpiluar ato në mënyrë të duhur juridike dhe duke i drejtuar në adresat e sakta. E gjithë kjo i ndihmon identifikimit të zbrazësive ligjore dhe atyre praktike në sistem, të cilat pastaj shërbejnë si bazë për

të ofruar rekomandime për të adresuar këto mangësi

Është inkurajues fakti që në përpjekjet e vështira për të luftuar korrupsionin nuk mungon vullneti qytetar për të bashkëpunuar. Sado që hezitimi për publikuar identitetin e tyre është evident dhe vjen si pasojë e mungesës së besimit mbi organet e drejtësisë, për gjysmë viti janë raportuar gjithsej 35 raste.

Ky raport pasqyron disa raste të raportuara në institucione publike dhe ofron rekomandime për përmirësim të situatës në këto institucione. Njëkohësisht përmend edhe disa aktivitete që janë organizuar në kuadër të Qendrës.

* vetëm nga operatori Vala, gjatë orarit E Hëne-E Premte (09:00-17:00)




RASTET E RAPORTUARA

Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit¹, që publikohet nga Transparency International e renditë Kosovën në vendin e 110 për nga shkalla e lartë e korrupsionit. Pavarësisht shkallës së lartë të perceptimit për korrup-

sionin dhe ndjeshmërisë së secilit prej nesh lidhur me këtë, qytetarët vazhdojnë të hezitojnë të denoncojnë rastet, kryesisht për shkak të mungesës së besimit në institucionet e drejtësisë. 35 rastet e raportuara në kuadër të këtij shërbimi i takojnë fushëveprimit të institucioneve në vijim:


1 <https://www.transparency.org/cpi2014/results>

▼ SIPAS SEKTORIT TË RAPORTIMIT KEMI NDARJEN NË VIJIM:





▼ SIPAS MOSHËS SË RAPORTUESVE KEMI NDARJEN NË VIJIM:



▼ SIPAS GJINISË SË RAPORTUESVE KEMI NDARJEN NË VIJIM:

65.7%
(23 raste)




MESHKUJ

14.3%
(5 raste)



FEMRA

20.0%
(7 raste)




TË PANJOHUR






▼ SIPAS MËNYRËS SË PËRFSHIRJES NË RAST, P.SH. A ËSHTË VIKTIMË, DËSHMITAR, SINJALIZUES ETJ. KEMI NDARJEN NË VIJIM:




Sa i përket natyrës së rasteve të raportuara, në këtë drejtim prinë moszbatimi ose zvarritja e vendimeve gjyqësore pasuar nga kurdisjet e tenderëve nga insti-

tucionet qendrore dhe lokale. Shkeljet e të drejtave të punës dhe nepotizmi gjatë punësimit të stafit të ri janë gjithashtu në nivel të lartë.

▼ GRAFIKU I MËPOSHTËM PARAQET NATYRËN E RASTEVE TË RAPORTUARA:





1) RASTET NË MINISTRINË E ZHVILLIMIT EKONOMIK (MZHE)

Të gjitha rastet e raportuara për keqpërdorime të mundshme ndaj kësaj ministrie i përkasin kurdisjes së tenderëve për shërbimet e nevojshme nga kjo ministri. Ankesat kanë qenë që përmes mënyrës së kuotimit janë krijuar kushte të atilla që fituesi të jetë ai i cili ka “plotësuar” kushtet. Për këto raste, më: 24.07.2015 zyrtari ligjor i është drejtuar MZHE-së me kërkesë për qasje në dokumentet publike për të analizuar më tutje rastin e raportuar. Dy nga këto raste të raportuara ishin nën hetime të Policisë së Kosovës (PK), dhe nuk mund të na lejohej qasje. Ajo që është vërejtur në këtë Ministri dhe tjerat është që shpalljet për prokurim përmes procedurës së kuotimit nuk janë publike. Edhe pse kjo nuk është kundër ligjit, praktika e tillë përjashton operatorët tjerë ekonomikë nga aplikimi në këta tenderë. Gjithashtu, vlera e kontratave është shumë e afërt me kufirin e lartë që mundëson ligji për këtë lloj prokurimi (9,725, 9,860 dhe 9,900 Euro secila).

Konkluzion: Të gjithë këta tenderë janë nën hetime. Veprimet e KDI-së për hulumtim të më tutjeshëm janë të kufizuara. Rezultatet nga hetimet do të monitorohen dhe do të përcillen nëse do të ketë ndonjë aktakuzë të ngritur si pasojë e dyshimeve të raportuara. Trendi i prokurimit sipas procedurës së kuotimit është në rritje, dhe në vitin 2014 ka arritur vlerën 21.8 milion Euro.

2) MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE (MAP)

Një rast i raportuar në këtë ministri ka ardhur si pasojë e dyshimit për kurdisje të kontratës me kuotim duke bërë të mundur fitimin e kësaj kontrate nga në Operator ekonomik i caktuar. Në mënyrë që të verifikohen pretendimet e ankuesit, zyrtari ligjor ka bërë kërkesë për qasje në dokumentet publike më datë 14.08.2015. Pas mungesës së përgjigjes, zyrtari ju ka shkruar sër-

ish edhe në adresat e ndryshme në datat 11 dhe 23 shtator, si dhe 6 tetor, dhe ka tentuar të kontaktoj përmes telefonit me ta, por nuk ka marrë përgjigje.

Ndaj kësaj ministrie, prapë kemi pasur rast të lajmëruara me tematikë të njëjtë, fitues me paramendim të tenderit të kurdisur, ku sipas raportuesit rasti ka të bëjë me një tender të vlerës nën 10,000 EUR, dhe diferenca në çmim mes fituesit dhe atij që ka qenë më afër fitimit, është vetëm 65 EUR. Njëjtë sikurse në rastin e parë, kemi kërkuar për qasje në dokumente publike, por pa përgjigje pozitive.

Meqenëse ishin shtjerrë të gjitha mjetet e brendshme të MAP-së, dhe kërkesat tona për qasje nuk kishin marrë përgjigjen e kërkuar, atëherë më 20 nëntor i jemi drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit për të dyja rastet. Brenda gjashtë ditësh kemi pranuar konfirmimin e ankesës si të bazuar, dhe ankesa është regjistruar me numrin 624/2015 në bazën e të dhënave në kuadër të këtij institucioni. Për të njëjtën shpresë kemi pranuar konfirmimin se do të njoftohemi lidhur me zhvillimin e hetimeve përkitazi me këtë rast.

Konkluzion: Edhe në rastet kur nuk kemi gjetur përgjigje në tentativat e para, ne nuk kemi hequr dorë nga kërkesat e tona, duke vazhduar tutje në institucionet e niveleve më të larta, siç dëshmon dhe ky rast, me kërkesa deri tek Avokati i Popullit.

3) UNIVERSITETI I PRISHTINËS (UP)

Gjatë periudhës së rekrutimit të stafit të ri akademik në UP, përkatësisht në Fakultetin Filozofik, Departamenti i Shkencave Politike, kemi pranuar telefonatë lidhur me dyshimin për nepotizëm të përfshirë në këtë proces, konkretisht të pranimit të kandidatës e cila është bashkëshorte (pa kurorë) e njërit prej anëtarëve të komisionit intervistues. KDI ka kontaktuar zyrtarët kompetent, duke kërkuar sqarim lidhur me këtë rast, ku janë përmendur emrat e personave të implikuar në



nepotizëm. Drejtori i Shërbimit për çështje akademike në Universitetin Publik të Prishtinës – Rektorat, është përgjigjur se të gjitha faktet do të merren në konsideratë dhe çdo gjë që është ligjore do të implementohet. Dhe pak kohë pas kësaj është marrë vendimi që të ndryshohet mënyra e rekrutimit, dhe kjo të bëhet nga Senati i UP-së për secilin fakultet.

Konkluzion: Pakënaqësia e qytetarit si rrjedhojë e veprimeve të padrejta në institucione sikur UP-ja, mund të shndërrohet në ndryshim të komplet një procesi i cili jo vetëm që do të ndalojë së ndodhuri rastin kryesor, por do të parandalojë edhe shumë raste të tjera që do të kishin mund të ndodhin.

4) AGJENSIONI KOSOVAR I PRIVATIZIMIT (AKP)

Ndaj këtij Agjencioni janë pranuar një numër raportimesh nga ish punëtorët e Fabrikës së Tubave në Ferizaj, për t'u ankuar në lidhje me padrejtësinë e bërë me vendimin për privatizim të fabrikës dhe largim të punëtorëve në mënyrën siç është vepruar. Zyrtari ligjor nga KDI ka kërkuar sqarim nga AKP, për moszbatimin e Aktgjykimit të formës së prerë me nr. C.nr.340/2001 të nxjerrë me datë 11 Janar 2002 nga Gjykata Komunale në Ferizaj, moszbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Ref. Nr.: AGJ 75/10, me numë rasti KI 08/09 të datës 17 dhjetor 2010, si dhe vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 04-V-799 të datës 19 mars 2014, lidhur me realizimin e të gjitha të drejtave nga marrëdhënia e punës që nga data 19.02.1990 deri më datë 01.05.2001 për 912 kreditorët (punëtorët) e Fabrikës së Tubave të Ferizajt.

Rasti ka vendime të të gjitha shkallëve ligjore, por ato nuk zbatohen sepse nuk është bërë themelimi i bordit të AKP-së nga Kuvendi.

AKTIVITETET TJERA

PROMOVIMI I LIGJIT PËR MBROJTJEN E INFORMATORËVE

Problem tjetër i cili në masë të madhe pengon luftën kundër korrupsionit, është moszbatimi i Ligjit 04/L-043 për mbrojtjen e informatorëve të korrupsionit. Ky ligj synon që të promovojë zyrtarët që të paraqesin veprimet e kundërligjshme në institucione pa bartur pasoja për vete. Në gusht 2015, KDI bashkë me Organizata të Shoqërisë Civile dhe Aktivistë për të Drejtën e Lirisë së Shprehjes u ka dërguar letër institucioneve më të larta shtetërore me kërkesën për ndërmarrë veprime për inkurajimin e sinjalizimit dhe mbrojtjen sinjalizuesve në Kosovë

Ky reagim erdhi për shkak se në gusht 2015 sinjalizuesi dhe ish arkëtari i bankës ProCredit z. Abdullah Taçi është dënuar me pesë mijë euro gjobë për shkak se ka nxjerrë jashtë bankës informata që ngrisin dyshime se drejtori i arsimit të Komunës së Prizrenit z. Nexhat Çoçaj ka përfituar në mënyrë të paligjshme të holla nga buxheti i komunës së Prizrenit. Pas publikimit të këtyre informatave, ndaj z. Çoçaj është ngritur aktakuzë për keqpërdorim të pozitës zyrtare. Z. Çoçaj, dyshohet, që ndër të tjera, me këto mjete ka paguar këste të kredisë dhe qiranë.

KDI në bashkëpunim me pjesëtarët tjerë të shoqërisë civile ka organizuar një performancë “ecje dhe fishkëllimë” në mbështetje të sinjalizuesit të korrupsionit, Abdullah Taçi. Ky aktivitet ishte vazhdimësi e aktivitetëve të shoqërisë civile për të kundërshtuar praktikën e frikësimit të qytetarëve dhe në shenjë solidarizimi me Abdullahun.

9 DHJETORI, DITA NDËRKOMBËTARE KUNDËR KORRUPSIONIT

Në vazhden e aktivitetëve bën pjesë edhe shënimi i 9 dhjetorit, Ditës Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit. Gjatë kësaj dite janë shpërndarë rekomandimet e vendosura në kartolinat uruese për një vit pa korrupsion, tek këto institucione:

- ▶ Kryeministri
- ▶ Këshilli Prokurorial i Kosovës
- ▶ Këshilli Gjyqësorë i Kosovës si dhe
- ▶ Deputetëve të Kuvendit të Kosovës.






Dita është shënuar simbolikisht me shpalljen e fituesve të garës fotografike #fajikorrupsionit, e organizuar nga KDI në bashkëpunim me UNDP. Kjo garë ka pasur për qëllim paraqitjen e efekteve shkatërruese që jep korrupsioni. Në garë kanë aplikuar mbi 100 persona duke postuar mbi 130 foto në rrjetet sociale Facebook, Twitter, Instagram me hashtagun #fajikorrupsionit (si dhe në gjuhët e tjera #becauseofcorruption apo #zboqkorupcije). Në këtë ditë janë ekspozuar 20 fotot më të mira sipas jurisë së përbërë nga pesë anëtarë (gazetar, fotograf profesionist dhe përfaqësues nga KDI dhe

UNDP). Të gjitha fotot e ekspozuara kishin mesazhet e veta të fuqishme, që më së miri u përshkruan nga Arbër Elezi, njëri nga fituesit kur tha se “Si mësues në shkollën e muzikës në Gjilan, është tepër rëndë të fotografosh nxënësit e tu duke mbledhur mbeturina. Ata kërkuan që unë të mos e publikoj këtë foto, por unë nuk mundem të mos e publikoj realitetin e hidhur dhe gjendjen e rëndë që këta po përjetojnë”. Të njëjtin mesazh e kishte edhe Shpëtim Dulaku, fituesi i çmimit të parë në këtë garë: “Unë ushtroj me këta të rinj tre herë në javë dhe kjo është ajo me çka ballafaqohemi tash e shumë kohë”.



Si mësues në shkollën e muzikës në Gjilan, është tepër rëndë të fotografosh nxënësit e tu duke mbledhur mbeturina. Ata kërkuan që unë të mos e publikoj këtë foto, por unë nuk mundem të mos e publikoj realitetin e hidhur dhe gjendjen e rëndë që këta po përjetojnë”.





REKOMANDIMET

Puna e deritanishme e organizatës sonë dhe e qendrës në mënyrë më të thuktë, na bën të jemi më të sigurt se rekomandimet tona do të kenë efektin e duhur.

PËR PROKURIMIN PUBLIK PËRMES KUOTIMIT

Duke parë trendin e vazhdueshëm të shpenzimit të buxhetit përmes “kuotimit”, si formë e prokurimit, KDI rekomandon që autoritetet kontraktuese, si Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Administratës Publike dhe institucionet tjera, të publikojnë në uebfaqen e KRPP-së apo edhe uebfaqet e tyre shpalljet për këtë lloj aktiviteti.

Gjithashtu rekomandojmë që të zvogëlohet shuma e lejuar e prokurimit përmes kuotimit nga 10,000 Euro në 5,000 Euro.

PËR KONFLIKT INTERESI NË PUNËSIM

Zbatimi i Statutit të Universitetit të Prishtinës në përpikmëri, bashkë me tërheqjen e pjesëtarëve të panelit të cilët kanë konflikt interesi do të përmirësonte këtë situatë.

Gjithashtu në afat më të gjatë është i nevojshëm pasurimi i dispozitave normative mbi parandalimin e konfliktit të interesit duke konkretizuar për rastet e funksionarëve të tillë.

PËR ZBATIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE (RASTIN E FABRIKËS SË TUBAVE)

Rasti i Fabrikës së Tubave në Ferizaj nuk është i vetëm, ka edhe raste të tjera të ngjashme në Kosovë. Andaj, ne rekomandojmë që Kuvendi ta vejë në prioritet funksionimin e bordit, në mënyrë që të bëjë zhblokimin e kësaj çështje tash e sa vite. Dhe në parandalim të rasteve kësajsoj, AKP-ja duhet që të definojë qartë fatin e punëtorëve të ndërmarrjeve që do të privatizohen.



**THIRR
MOS U VONO**

0800 77 777

**KORRUPSIONI PAMUNDËSOHET
KUR RAPORTOHET**

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni www.kdi-kosova.org

Me përkrahjen financiare të:

